

VENDIM
Nr. 52, datë 3.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Përmbajtja e nenit 13, ndryshon si më poshtë vijon:

“Neni 13
Ristrukturimi i kredisë

1. Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, rristrukturojnë kredinë, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet e saj drejtuese. Ristrukturimi i kredisë kryhet kur, mbështetur në analizat e tyre, bankat gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë, sipas kushteve të reja.

2. Kredia, e cila para rristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse rristrukturohet për herë të parë, pas rristrukturimit nuk mund të klasifikohet, në asnjë rast, më lart se kategoria “nënstandarde”, deri në plotësimin e kushteve të pikës 5 të këtij neni. Kredia, e cila para rristrukturimit klasifikohet në kategoritë “nënstandarde”, “të dyshimta” ose “të humbura”, nëse rristrukturohet për herë të parë, pas rristrukturimit ruan të njëjtën klasë, deri në plotësimin e kushteve të pikës 5 të këtij neni.

3. Kredia, e cila para rristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse rristrukturohet për herë të dytë, pas rristrukturimit nuk mund të klasifikohet, në asnjë rast, më lart se kategoria “e dyshimtë”, deri në plotësimin e kushteve të pikës 5 të këtij neni. Kredia, e cila para rristrukturimit klasifikohet në kategoritë “nënstandarde”, “të dyshimta” ose “të humbura”, nëse rristrukturohet për herë të dytë, pas rristrukturimit klasifikohet në një klasë më të ulët nga kategoria në të cilën ishte klasifikuar përpara rristrukturimit, deri në plotësimin e kushteve të pikës 5 të këtij neni.

4. Kredia, e cila është rristrukturuar për më shumë se dy herë, pas rristrukturimit klasifikohet, në kategorinë “të humbura”, deri në plotësimin e kushteve të pikës 5 të këtij neni.

5. Kredia e rristrukturuar sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni, me plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë rregullorë:

a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt këstet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga data e rristrukturimit dhe këstet gjatë kësaj periudhe duhet të jenë materiale krabasuar me këstet e planit të pagesës të parashikuar për periudhën në vijim;

b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 4 (katër) këste (kryegjë dhe interes).

Në rastin e kredive që përfshijnë edhe një periudhë “grace”, si datë e rristrukturimit, do të konsiderohet data e mbarimit të kësaj periudhe.”;

b) Në nenin 17, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

i) Në pikën 2, togfjalëshi *“jo më vonë se tri vite”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“jo më vonë se dy vite”*.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të shkronjës “a”, të pikës 1, që hyn në fuqi më 1 janar 2021.

KRYETAR
Gent Sejko